



PROCESVERBAL

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 2 (dytë) të rregullt për vitin 2026, të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi :	Suharekë
Zyra :	Salla e Kuvendit të Komunës
Data:	30.01.2026
Ora:	10:00

Prezentë në takim:

Znj. Sanie Kuçi
Rexhepaj

Z. Flamur Bytyçi

Znj. Doruntina Zenelaj

Z. Urim Suka

Z. Astrit Salihu

Z. Nexhat Ramadani

Znj. Vlorë Kryeziu

Znj. Dafina Kolgeci

Z. Bexhet Kuçi

Z. Visar Kuçi

Z. Mensur Selimaj

Z. Edon Sadikaj

Z. Aziz Bytyçi

Znj. Mimoza Bajraktari

Z. Enver Shabani

Znj. Albulena Kokollari

Znj. Besa Kuçi

Z. Dardan Berisha

Z. Armend Krasniqi

Z. Labinot Halitjaha

Znj. Afërdita Mamaj

Znj. Merita Basha

Znj. Antigona Zyba

Z. Liridon Fandaj

Z. Qëndrim Elshani

Znj. Laureta Tafaj

Znj. Jehona Rrafshi

Lumi

Të pranishëm tjerë:

Kryetari i Komunës

Media dhe qytetarë

OSCE, LMT, KDI

Znj. Habibe Bytyqi

Z. Xheladin Sadikaj

Takimin e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z.Bexhet Kuçi,i cili i njoftoi me rendin e ditës.

REND DITE

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e të hyrave dhe të dalurave të buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2026;**
3. **Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet rendi i ditës

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedhë në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet pika 1

Pika 2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e të hyrave dhe të dalurave të buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2026;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - unë e kam një kërkesë fillimisht para se me hap debatin që për secilën pikë të rendit të ditës së pari ekzekutivi ose sponsorizuesi i atij projekt-vendimi me shtjellu më detaisht se çka ka ndodh në këtë rast me buxhetin.Çka ka planifiku?Si e ka planifiku?Cilat kategori?Çka ka ndodh?Pse pagat janë rritur? të gjitha arsyet e veta dhe pasi ta dëgjojmë fjalën e sponsorizuesit pastaj të hapet debati.Nëse është e mundshme kjo me ndodh sot sepse po e shohim që Kryetari ka vendos këtë mandat me kry vet,pa drejtor.Nëse është e mundur Kryetari me na prezantu buxhetin e pastaj me hap debatin.

Kryesuesi - po,ju veq jeni të informuar me qarkoren.

Kryetari - e dini që qarkorja vjen në qershor ku paraqitet tavani prej Ministrisë së Financave.Është e ndarë në kategori ku pagat janë 13.572.000€, mallra dhe shërbime 3.328.000€,komunali 484.000€,subvencione 1.210.000€ dhe investime kapitale 5.934.000€.Komplet buxheti për vitin 2026 është 23.789.000€.Ju e dini që 2 vitet e kaluara kemi pas sfida ku vetëm vitin e kaluar janë marrë 3.082.000€.Deri tash kemi afërsisht minus 8.000.000.Buxheti është ndarë në bazë të numrit të banorëve.Në KPF e diskutuam që mjetet të cilat janë zvogëlu nëpër fshatra,kanë kalu te objekti i zjarrëfikësave ku e kemi donacion e që vlera e tij është 600.000€,dhe aty kanë shku 250.000€.

Flamur Bytyçi - pse ne nuk e kemi një raport të shpenzimeve të vitit të kaluar për me ditë sa dhe a kemi obligime të papagura si komunë ?

Kryetari - ju e dini që të hyrat vetanake nëntor-dhjetor nuk shpenzohen,ato mbyllen.Muajin e ardhshëm vjen raporti komplet.

Liridon Fandaj - po na kërkohet një buxhet me votu pa njerëz që marrin përgjegjësi dhe me një listë fontanë dëshirash por jo me një plan buxhetor qeverisës që secili drejtor me marrë obligimin dhe me ditë çka ka me punu për vitin 2026,por edhe për 4 vjeqarin sepse prej muajit në muaj po ndryshojnë gjanat.Në muajin e nëntë 2025 na është sjell një buxhet ku te investimet kapitale janë disa vlera shumë të mëdhaja por jo edhe të arsyeshme për planifikimin e projekteve që janë bë.Për çudi tash na vjen një projekt kapital tjetër që vlerat janë të zvogëluara.A kanë ndryshu projektet?A kanë ndryshu paramasat?A janë ulë çmimet?Ne sot ankohe mi për çmime të ngritura e vlerat për ato projekte të njejta janë zvogëlu.Bllaca atëherë ka qenë 80.000€ dhe tani është 70.000€,projekte të njejta.Budakova njejtë,minus 10.000€,Bukoshi,Duhla,Peqani,Leshani,Gjinoci,Mushtishti,Nishori.Në secilin pozicion janë ulë vlerat por projektet nuk kanë ndryshu.Është një projekt për impiante në fshatin Sllapuzhan ku gjatë gjithë fushatës Kryetari çdo debat i ka përmend 2 impiante,një në Dubravë dhe një në

Sllapuzhan.Ka shku në Sllapuzhan dhe ju ka premtu që ka m'u bënë një impiant,çka ka me thanë tash që e ka heq krejt atë impiantë dhe ato mjetet që i ka heq krejt prej projekteve kapitale,i ka qu te zjarrëfikësat dhe te arsimi(te qerdhja ku e ka planifiku me bo).Është një kontraditë që në planin e punës së vet që e ka prezantu me 30.12 dhe e ka publiku në faqe,projektet kapitale janë të njejta të datës 26.09.2025.Cilën me marrë për bazë qytetarët?Për shkak të kontraditave dhe ndryshimeve që i bënë vet Kryetari,pa konsultim ku ne edhe herën e kaluar kemi pas një drejtor i cili tani sot është koleg me neve, e ka kundërshtu atë projekt-buxhet për shkak se nuk është konsultu edhe pse ka qenë nëpër dëgjime publike.Ky projekt buxhet është fontanë dëshirash i Kryetarit por jo i zbatueshëm edhe për qytetarin.

Urim Suka - kur kërkova që pikën e rendit të ditës me shtjellu dikush,në këtë rast Kryetari,mendova që ka një qasje pak ma serioze,por siç është përgadit dokumenti edhe spjegimi i tij ishte i mangët dhe nuk ishte gati përmbushje e asaj që ne me pas arsye për me votu,por e kundërta është një arsye për mos me votu.Vendimi për buxhetin si një nga vendimet kryesore që ky kuvend merr,nga i cili burojnë një numër i vendimeve tjera për implementimin e tij në teren meriton trajtimin tonë maksimal me qëllimin që ti ofrojmë qytetarëve një buxhet zhvillimor dhe që përfaqëson në mënyrë sa ma reale nevojat e tyre në teren.Andaj si grup i LDK-së jemi munduar që ta analizojmë në detaje këtë dokument me të vetmin qëllim që të japim kontributin tonë që ky dokumet të jetë në shërbim të gjithë qytetarëve pa dallim.Ajo që na shqetëson më shumë është fakti që gjatë gjithë fazave për përgaditjen e këtij dokumenti,këtë pushtet e ka përcjell papërgjegjësia dhe mungesa e theksuar e profesionalizmit dhe si e tillë kjo për ne është e papranueshme.Dua të theksoj që kjo është hera e dytë që po e trajtojmë këtë buxhet sepse në seancën e 26 shtatorit të vitit 2025 ky buxhet është trajtuar dhe nuk i ka marrë votat e mjaftueshme për me kalu tutje.Në këtë situatë një pushtet i përgjegjshëm,kur një draft nuk kalon,do të duhej të paktën të analizonte vërejtjet që kishim në seancën e parë e ti evitonte të gjitha ato që janë të argumentuara.Një pushtet i përgjegjshëm do të duhej që minimalisht të ftonte shefat e grupeve në një takim ku do ti prezantonte këto ndryshime e do të kërkonte sugjerime nga ta dhe pastaj ta sillte këtë buxhet në seancën e të diskutonim ndoshta jo për këto vërejtje të çuditshme që janë sot por për konceptin pse po investoni këtu,pse janë prioritet këto etj.Sot pothuaj është sjell buxheti i njejtë me herën e kaluar dhe kjo është arrogancë,papërgjegjësi dhe si e tillë meriton votën tonë kundër të secilit prej nesh pa prejashtim partie.Jo për ta ndëshkuar por për ti dhënë mundësi që ky dokument të bëhet minimalisht i pranuar për shumicën në kuvend dhe dokument që nuk prodhon shkelje ligjore gjatë implementimit në teren.Më lejoni që në emër të grupit të kuvendarëve të LDK-së ti theksoj disa nga argumentet pse jemi kundër këtij projekt-buxheti.Shqetësimi parë është fakti se interesat qytetare nuk përmbushen siç janë nevojat e tyre në teren.Shembull:në shumicën e vendbanimeve kemi të planifikuara rrugë lokale por paramendoni disa fshatra,si Duhla,Nishori,një pjesë e Bllacës por edhe plot tjera kanë mungesë të ujit të pijshëm dhe askund në këtë buxhet,në asnjë fshat nuk është parapa që të investohet për furnizim me ujë.Pastaj në shumicën e pozicioneve ,si te kanalizimet,ndriçimi publik,ndërtimi i trotuareve mungon specifikimi.Paramendoni,në planifikim për fshatin Shirokë shkruan:Ndërtimi i impiantit të ujërave të zeza në Dubravë 20.000€,ndërsa në një pozicion tjetër janë prap të planifikuara 130.000€ për impiantin e ujërave të zeza në Dubravë. Por ajo që është edhe më e çuditshme ka të bëjë me propozimet e asambleistëve në seancën e 26 shtatorit.Aziz Bytyqi,Saranda Bajraktari dhe Jehona Lumi i kanë bërë disa propozime për disa projekte me hy në buxhet në atë seancë dhe vetëm një rrugë në fshatin Nishor që e ka propozu Jehona ka hy në këtë buxhet.Në këtë projekt-buxhet për fshatin Budakovë figurojnë për ndërtim rrugët: „Rruga e UÇK-së,Ali Buqa dhe Sherif Buqa“ mirëpo unë këtu kam kontratën për vitin 2025 për ndërtimin e këtyre rrugëve.Sipas kontratës tani ato duhet të jenë të shtruara por të njejtat rrugë figurojnë në këtë buxhet për vitin 2026.Në fshatin Delloc në këtë projekt-buxhet figuron ndërtimi i rrugës lokale Elez Isufi dhe rruga Dielli.Por unë këtu kam një kontratë që figuron që këto dy rrugë janë shtruar gjatë vitit 2025.Në fshatin Duhël,në planifikimin e vitit 2025 ka figuru ndërtimi i rrugës „Haxhi Bujari“ dhe sipas informatave që kam marrë nga banorët,kjo rrugë nuk është shtruar fare por e çuditshme është që kjo rrugë nuk figuron as në planifikimin e vitit 2026.Në fshatin Gelancë,në këtë kornizë figuron për tu shtruar rruga“Sherif Çadraku dhe rruga Gani Kukaj“ mirëpo e vërteta është që këto dy rrugë janë të shtruara dhe janë rrugë kryesore të fshatit.Mandej këto dy rrugë kanë figuru edhe në planifikim e vitit 2025 kur është bërë kontrata për me u shtru dhe sipas informacioneve që kam marrë atje,me këtë kontratë janë shtruar dy rrugë familjare ose janë shtruar dy oborre.Këtu i kam fotot.Por përveç kësaj këto dy rrugë po figurojnë prap në këtë kornizë.Ndërtimi i rrugëve lokale në Suharekë 80.000€.A ka mundësi me ditë se për cilat rrugë bëhet fjalë, apo keni në plan me shtru oborre dhe nuk mund ti vendosni emrat?Deri sa nuk janë emrat,ku e dini sa kushton,sa para duhet të planifikohen?Dua ti adresoj

disa çështje bazike të fshatit Bllacë të cilat çuditërisht edhe pse po i adresoj që një kohë të gjatë, nuk po gjejnë mbështetje. Kam fol edhe më herët për mungesën e trotuarit në dalje të Bllacës që shkon rrugës për Malishevë. Ajo është rrugë kryesore, mungon trotuari dhe fëmijët ecin rrugës dhe rrezikohet jeta e tyre dhe prap nuk po gjen zgjidhje edhe pse duhen shumë pak mjete. Problemet me kanalizim, së fundmi janë lajmëruar edhe disa shakte të bllokuara tek shelqet, edhe në rrugën „Zegolli“ me vite janë ato probleme. Ju keni vendos impiant të ujërave të zeza për Dubravë por Bllaca ka nevoja të madhaja për impiant të ujërave të zeza dhe nuk ka vend as në këtë kornizë për tri vitet e ardhshme. Rruga „Albanika“ është një rrugë kryesore që lidh dy lagje dhe që lidh hapësirë për varreza, është përmend nga unë dhe nga Jehona dhe prap nuk është e planifikuar për vitin 2026 dhe është jashtëzakonisht e nevojshme për me shtrë. Ura në hyrje të fshatit Bllacë nuk ka rrethoja dhe nxënësit çdo ditë kalojnë aty dhe mund të bijnë edhe në lumë. Për veq se ju keni disa pozicione për ura nëpër fshatra tjerë, Bllacën e keni të harruar. Shtratin e lumit e kam përmend disa here dhe asnjëherë nuk është hap në Bllacë dhe as në këtë buxhet nuk parashihet të hapet. Uji atje po del nga shtrati dhe po bën dëme. Ky dokument për veq se është buxhet për vitin 2026 është edhe KAB dhe planifikon projekte për tri vitet e ardhshme dhe për fatin e keq në këtë kornizë nuk janë të planifikuara as projektet që vet i keni promovu në fushat. P.sh. shkolla “7 Marsi” mandatin e kaluar gati çdo herë ka qenë në planifikim, tash s’është në planifikim në këtë kornizë tri vjeqare. Nevoja është e madhe për me ndërtu atë shkollë dhe kjo është për keqardhje, një arsye plus pse duhet mos me votu këtë kornizë. Ndërtimi i objektit të ri të Eko Therandës, vet e keni premtu dhe askund nuk e pash të planifikuar në këtë kornizë. Ndërtimi i çerdhes bashkëkohore në qytet, vet e keni premtu dhe ka nevojë për një çerdhe në qytet por askund nuk figuron ndërtimi i kësaj qerdhe. E keni promovu stacionin e autobusave dhe edhe ne mendojmë që ka nevojë me u ndërtu stacioni i ri por nuk po figuron askund në këtë kornizë tri vjeqare. Palestra gjysëmolimpike ishte edhe pjesë e planit tonë, është e nevojshme me u ndërtu por s’po figuron askund. QKMF e re, edhe ne mendojmë që Suhareka meriton me pas QKMF të re por askund nuk po figuron edhe kjo. Më lejoni që në emër të grupit të kuvendarëve të LDK-së të bëj thirrje secilit prej jush që ta votojmë kundër këtë vendim me idenë që ti japim mundësi të përmirësimit të këtyre vërejtjeve dhe në një seancë tjetër pas përmirësimeve të nevojshme ta diskutojmë dhe miratojmë të gjithë bashkë. Nëse votohet kështu dëmton interes qytetare dhe krijon mundësi të reja për aktakuza të reja sepse implementimi në teren në këtë formë siç ka ardhë bëhet duke shkel ligjin siç keni vepru në vazhdimësi këto vitet e fundit.

Flamur Bytyçi - edhe në KPF e kam kundërshtu Kornizën Afatmesme Buxhetore por çështja që mua më shqetëson më së shumti që ne po diskutojmë dhe që e kemi diskutu gjithmonë është që dokumentet zyrtare që na vijnë secilën here janë me gabime amatore. Komuna shpenzon mjete të veta për emërtimin e rrugëve dhe ju në dokumente publike gaboni edhe emrat e rrugëve. Me këtë veprim duke u nis prej të kaluarës, ne i kemi rreziku edhe shërbyesit civil që kanë qenë mbikqyrës të kontratës dhe është dasht me u ballafaqu nëpër gjykata. Për veç kësaj që mua më duket jo serioze ky dokument, shqetësimi i dytë është që nuk keni para asgjë për ujësjellës gati në asnjë fshat. Për deri sa ju parashihni me ndërtu një sallë të sportit në Peqan e nuk parashihni asnjë ndarje për ujësjellës, për mua është e pakuptueshme.

Astrit Salihu - materialin të cilin e kam pranë për buxhet, jam mundu me analizu dhe dua të ndalem te fshati Mushtisht. Janë parapa me u shtrë disa rrugë apo më mirë të them segmente të cilat do të punohen këtë vit. Unë mendoj që për një vendbanim të madh si Mushtisht, janë pak. Është edhe një rrugë këtu e cila nuk ekziston fare, ku shkruan: shtrimi i rrugës “Hazir Behluli” në Mushtisht por rrugë Hazir Behluli nuk ka. Në fshatin Mushtisht janë afërsisht 15 km të papërfunduara dhe ka shumë lagje që e kanë problem parësor këtë çështje dhe e pash që në vitin 2026 nuk do të investohet as edhe 1 metër në kanalizim. Çështje tjetër është edhe ndriçimi. Duke e ditë që fshati Mushtisht ka shumë problem me ndriçim, ndoshta është më keq se çdo fshat tjetër në Komunën e Suharekës pasi mbi 80% e dritave në fshat nuk punojnë, madje edhe qendra e fshatit është komplet në errësirë. Edhe për këtë problem e pash që në vitin 2026 nuk do të investohet fare. Duke u pajtuar me gabimet dhe gjetjet të cilat i dhanë parafolësit tonë nga grupi jonë dhe duke i shtuar pjesët që ky buxhet nuk i ofrohet pritjeve që kanë pas bashkëvendasit e mi për këtë vit, unë nuk mund ta votoj këtë buxhet.

Doruntina Zenelaj - unë i mbështes parafolësit e mi dhe mendoj që ky buxhet nuk duhet të miratohet për disa arsye. Në fshatin Savrovë keni paraparë të shtrohet rruga “Pllava”. Pasi jam rritur në këtë fshat dhe në bazë të hulumtimeve, kjo rrugë nuk ekziston fare. Rruga e UÇK-së dhe rruga Dubravë-Savrovë është e njejta rrugë, gjithëashtu është e përfunduar. Rrugë që kanë nevojë të shtrohen nuk i keni fut në buxhet ndërsa tjerat i keni futur nga dy herë. Impianti i ujërave të zeza në Dubravë ka qenë në vitin 2024 dhe në vitin 2025, projekt që është buxhetu, e keni planifiku dhe në fund nuk është realizu. Vorrezat në

Gjinoc, Dubravë dhe në Biraq-Suharekë shumë mirë që po bëhen por çka për varrezat e fshatit Vraniq? Mandatin e kaluar kemi kërkuar për rrethim-pastrim të vorrezave dhe e dime që e keni pas një takim me shoqatën e Vraniqit dhe jeni zotu që në gjashtëmuajin e parë të këtij viti do ti rrethoni dhe pastroni, e ju as që i keni fut në buxhet. Në Vraniq rrugët “Ali Loshi dhe Udha e shkronjave” segment janë të shtruara dhe janë prap në buxhet. Kemi fut rrugë lokale pa emërtim. Ju e keni pas hartimin e projekteve dhe ky buxhet është dasht me buru prej atij hartimi. Nëse sot na ka ardhë për votim ky buxhet, nuk i ka as kriteret minimale të buxhetimit të projekteve kapitale. Rrugën “Muhamet Ilazaj” në Sopijë nuk e keni specifikuar se a është segment apo rruga kryesore, sepse nëse është rruga kryesore, ajo është e shtruar. Për ndriçim ju keni kontratë 2.056.000€ me energji efikiente, e çka jeni duke bërë tash me këto investime për instalim dhe sanim nëpër fshatra? Tek arsimit fillor: Rikonstruimi i shkollave në komunë, keni nda 59.227€, ku do ti shpenzoni këto para, në cilat shkolla? Nuk janë të specifikuar.

Nexhat Ramadani - ashtu siq e tha edhe përfaqësuesi i grupit të LDK-së, sot ne duhet të marrim një prej vendimeve më të rëndësishme brenda vitit që merret nga Kuvendi i Komunës siç është buxheti. Andaj unë mendoj që çdo vendim i komunës është i rëndësishëm por për këtë duhet të ketë më shumë punë, përkushtim por edhe përgjegjësi. Unë në bazë të përvojës që kam pas edhe si asambleist në mandatet e kaluara përpos të fundit që nuk kam qenë, e njoh natyrën e kësaj qeverisje dhe e di qysh bëhen buxhetet por unë kam shpresë që sot në këtë mbledhje do të kemi një projekt-buxhet i cili do të ketë përmirësime ose reflektim krahasuar me atë që ka qenë përpara, por avazi është i njëjtë. Krejt çka e karakterizon këtë projekt-buxhet është joserioziteti, joprofesionalizmi dhe mbi të gjitha papërgjegjësia. Te jo profesionalizmi, edhe pse po e them unë, mendoj që brenda komunës ka staf i cili mund të kryejë punë shumë të mira. Është çështje e papërgjegjësisë edhe të Kryetarit dhe të drejtorave ndoshta sa i angazhojnë ata, sa i konsultojnë ata dhe si i trajtojnë ata. Unë kam shpresë që do të ketë ndryshime dhe e pyeta veten se a ja vlen të diskutohet. Nëse e sheh një projekt-vendim të tillë, i njëjti ka disa mandate, thua më mirë mos me diskutu. Si do që të jetë, unë jam delegat këtu dhe për hir të qytetarëve por edhe kolegëve delegatë do ti them disa çështje pse unë me keqardhje kam vendos mos me votu ashtu siç ka vendos edhe grupi parlamentar. Dikush mendon që ne po e bëjmë këtë vetëm pse jemi opozitë por ne nuk kemi karakter të tillë por kjo ndodh sepse ju jeni të papërgjegjshëm. Ajo që e karakterizon këtë buxhet është mospasqyrimi i nevojave reale qytetare, investime në segmente të rrugëve private pa emra duke anashkaluar prioritetet kryesore, përsëritje të projekteve, projekte tash të përfunduara, mosrespektim edhe të vendimeve të Asamblesë që ka marrë më herët. Unë dua të jap edhe disa argumente tjera për me plotësu atë pse unë kam vendos, jo me dëshirë por për shkak të këtyre fakteve dhe e kam marrë shembull fshatin tim. Në fshatin tim shoh që keni planifikuar në 2026-tën rrugët: Ismet Kodra-segment, Bashkim Kabashi-degëzim dhe Shaban Gashi-segment, ndërkohë që ne ende kemi rrugë që kanë emërtim sepse këto segmente kuptohet që nuk kanë emërtim, janë rrugë të shkurta, rrugë të oborreve ose private. Ndërsa ne kemi rrugë që janë të interesit të përgjithshëm sikur që është rruga Lasgush Poradeci e për të cilën ju keni pas 4 kontrata prej vitit 2020, keni bërë disa investime dhe ja cila është gjendja e asaj rruge sot pas 6 vitesh. Pa asnjë problem pronësor, pa asnjë pengesë dhe nuk kryhet. Kemi rrugën Kastriotët ku ka mbi 10 shtëpi, pastaj Vitia të ciliën e keni pas në projekt në të kaluarën dhe tash nuk është, dhe shumë rrugë tjera. Rruga Shaban Gashi, në Leshan nuk ka rrugë Shaban Gashi. Ka është kjo rrugë? Ndoshta është fjala për rrugën Shadan Gashi dhe atë e kanë shkruar segment dhe në vitin 2023 e keni pas tender si rrugë të parë dhe nuk e keni shtruar. Në çdo vendbanim keni segment dhe kjo nënkupton që janë rrugë private. E përmendi dhe Dorentina ku ka rrugë të cilat janë të përfunduara dhe i keni pjesë të këtij projekt-vendimi sikurse rruga e UÇK-së. Në vitin 2025 në Nepërbisht keni miratuar në Asamble mandatin e kaluar rruga e varrezave në Nepërbisht, ndërkohë në kontratë e keni fut rruga “Ali Dërvishi, Haki Muslia”. Faktikisht në emër të kontratës e keni shkruar rruga e varrezave në Nepërbisht për me kriju hutin, ndërsa te paramasat e keni shkruar Ali Dërvishi dhe Haki Muslia dhe këto dy rrugë janë kryer ndërsa rruga e cila është miratuar në Asamble nuk është kryer. Ngjashëm e keni edhe në Reqan. Në vitin 2025 e keni rrugën Te Lapidari të miratuar, në kontratë e keni vendos emrin Te Lapidari ndërsa në paramasa keni shkruar: Ram Muharremaj-degëzim, Fejzullah Uka, Lulzim Veselaj-degëzim dhe Adem Mehmeti. Ngjashëm e keni në Nishor, Studenqan e në të gjitha vendbanimet. Cila është arsyeja me votu këtë buxhet? Me keqardhje ashtu si edhe pjesa tjetër e grupit parlamentar, unë nuk mund ta votoj një buxhet të tillë.

Qëndrim Elshani - singërisht ne po kemi dëshirë me votu buxhetin por papërgjegjësia e ekzekutivit po na pamundëson një gjë të tillë. Për mos me u zgjat sikur kolegët e mi që pothuaj i përmendën të gjitha parregullsitë e këtij buxheti, sot po kërkohet m'u votu buxheti por kemi dy versione të ndryshme e një

plan pune që nuk po përputhet. Cilat projekte do të implementohen, të dates 26 shtator 2025 dhe plani i punës që ka ardhë me 30 dhjetor 2025 apo ky i seancës së sotme?

Kryesuesi - faktikisht e kemi secili përpara projekt-buxhetin dhe ky do të implementohet.

Dardan Berisha - u dhanë shumë diskutime realisht edhe shumë projekte të cilat për këtë kornizë buxhetore na duhen nja 10 milion për me i implementu, por mendoj që duhet t'ia lëmë kohës. Sa i përket dëgjimeve publike që u diskutuan, duke u nis nga vetja, ne nuk kemi marrë pjesë pothuaj se asnjëherë në dëgjime publike, menzi kemi prit me dështu dëgjimet publike që me pas një vërejtje të buxheti dhe me ardhë këtu e me thanë që nuk na keni dëgjju, nuk janë projektet tona, përveq disa asambleistëve që janë më koherent në këtë drejtim, konkretisht Liridoni ka marrë pjesë nëpër të gjitha dëgjimet. Unë mendoj që buxheti përfshin të gjitha fshatrat e komunës tonë duke garantuar balancë të barabartë të lokaliteteve në përputhje me nevojat e qytetarëve. Në këtë buxhet janë të fuzionuara edhe projektet e propozuara nga grupi i asambleistëve të PDK-së, projekte këto që kanë për qëllim përmirësimin e infrastruktures, shërbimeve publike dhe shumë projekte tjera në interes të qytetarëve. Përtej dallimeve politike kemi obligim ndaj qytetarëve ta miratojmë buxhetin në mënyrë që komuna të funksionojë normalisht dhe projektet e planifikuara të mos vonohen më tej. Unë kam qenë që tri legjislatura asambleist dhe e di që edhe në legjislaturën 2017-2021 kur kemi qenë në opozitë, kemi kaluar buxhetin me disa ndryshime. Mendoj që Kryetari e ka për obligim ligjor që 5 % mundet me ndryshu, ndoshta mundet me qenë gabim. Kryetari i komunës mundet me ndryshu 5 % buxhetin sipas vetvetes dhe në harmoni me këtë shumë prej 23.125.000€ i bie që mundet me i delegu ka të do vet. Arsyeja pse nuk e kemi votu në shtator, kanë qenë rrethanat të cilat janë kriju në fund të mandatit por mbi të gjitha ne nuk e kemi votu në shtator për arsye të koncenzusit. Në këto çaste ne si grup i asambleistëve të PDK-së jemi pro këtij buxheti.

Urim Suka - unë po kam dëshirë me ndëgju edhe fjalën tuaj. Unë e thashë që për fshatin Shirokë po shkruan impianti në Dubravë dhe ju as atë s'po doni me ndryshu dhe ashtu po e vendosni në votim. Për Budakovë thashë që janë disa rrugë që janë në kontratë, normal duhet me qenë të shtruar, po figurojnë prapë e ju po doni me i lënë ashtu, e shumë vërejtje tjera. Unë i përmenda disa asambleistë që kanë bo propozime dhe sot nuk po flasin por ato propozime e tyre që janë hedhë në votim atëherë nuk kanë reflektuar. PDK nuk e ka votu buxhetin me 26 shtator, tash ka ardhë i njeiti buxhet, pa asnjë ndryshim por disa fshatrave ju kanë zvogëlu mjetet edhe tash ata po thojnë dojmë me votu. Është e drejtë e tyre por le të dihet që nuk janë konsistent me atë çka kanë thënë më herët.

Dardan Berisha - unë e thashë nuk e kemi votu për shkak të disa rrethanave të cilat janë kriju në fund të mandatit dhe në mungesë të koncenzusit. Tash të gjiha projektet e PDK-së të propozuara prej grupit të asambleistëve janë të fuzionuara në buxhet. Në vitin 2019 grupi i asambleistëve të LDK-së e ka votu buxhetin pa asnjë kërkesë sepse kanë qenë zgjedhjet parlamentare. Ne këtë buxhet e shohim si vullnet të të gjithë asambleistëve për të votu dhe për ti dhënë shërbime qytetarëve sepse në mungesë të dorës tonë ndoshta mund të pësojnë shumë qytetarë të cilët nuk kanë faj në këtë drejtim.

Nexhat Ramadani - jo për ta kundërshtu Dardanin por për ta plotësu sa i përket asaj që tha se Kryetari ka të drejtë 5% . Ndryshimet me 5% i lejon ligji atëherë kur ka arsye, kur ka pengesa bazë me të cilat atëherë Kryetari i lejohen ndryshime dhe jo me thënë bën çka të duash. Çfarë e drejtë është ku në Nepërbisht 100% projektin e ka ndryshu dhe s'ka të bëj me 5 %.

Dardan Berisha - projektet të cilat janë heq edhe në Gjinoc, janë heq shuma të cilat në shtator të 2025-tës ka qenë shumë tjetër dhe tash është shumë tjetër për fshatin Gjinoc. Te varrezat, që i përmendi edhe kolegja, rrethojat në Vraniq janë. Në Vraniq ka problem tjetër të varrezave por ne kemi nevojë për rrethoja dhe jo për parcellë, është dallim tjetër. Unë e thash: ne po e konsiderojmë që e ka ndryshu 5 % duke e marrë shumën totale.

Jehona Rrafshi Lumi - sa i përket buxhetit unë do ta votoj këtë buxhet për disa arsye, për shkak që propozimet e mia janë të vendosura në këtë buxhet. Është rruga Hamdi Beqa në Nishor, siq e ceke, është rruga Kukësi në Bllacë, Albanika në Bllacë. Është e pamundur të gjitha të hyjnë për shkak që e dimë që nuk është e mundur kjo me u bo dhe aty ku unë mendoj dhe në koordinim me qytetarët është e përfshirë në buxhet.

Flamur Bytyçi - Dardan, 5% Kryetari ka të drejtë me ndryshu vetëm pasi të kalon kjo, jo tash kur po e diskutojmë.

Urim Suka - është e drejtë e Jehonës me votu siç don ajo. E përmendi rrugën Albanika, por rruga Albanika nuk është për vitin 2026 por është për vitin 2027.

Kryesuesi - e hedhë në votim pikën 2.

Pika 3. Pyetje dhe përgjigje;

Jehona Rafshi Lumi - meqenëse sot patëm vonesë të fillimit të seancës për shkak të energjisë elektrike, k'ërktoj dikush nga ekzekutivi të jap arsyetim. Pse ndriçimi publik në atë kohë(ditën) ishte i ndezur në pjesë të qytetit, rrugës prej Flamuri Petroll e tutje?

Kryetari - janë duke punu dhe kur punojnë ditën, duhet me lëshu me ditë ku ka defekte.

Urim Suka - Pyetja 1. Unë këtu kam kontratën për ndërtimin e rrugëve në fshatin Reshtan. Në fletën e parë figuron ndërtimi i rrugës Kadri Morina ndërsa në fund të kontratës, në paramasë figurojnë rrugët: Arrat-degëzim, Rruga Donikë Kastrioti dhe rruga Balajt-vazhdim. Dua të di Kryetar nga ju, pse është bërë ky ndryshim që në fletën e parë të kontratës emër tjetër, në paramasë emra tjerë? A është falsifikim i dokumentit zyrtar ky ndryshim? Cilat rrugë janë shtruar në teren meqenëse e kemi këtë mospërputhje në kontratë? Pyetja 2. Në lagjen Zekolli dhe tash së fundi edhe te Shelqet që janë disa lagje që është blloku kanalizimi, kanë jashtëzakonisht shumë probleme. Kjo situatë për ata banorë është bërë e padurueshme. A ka mundësi që komuna me interveni, me i bërë zgjidhje atyre banorëve dhe kur?

Kryetari - ju e dini që në mandatin e parë 2021-2025 janë zgjedhur kryesitë e fshatrave prej asamblesë komunale. Keni marrë pjesë prej të gjitha partive politike. Kërkesat vijnë prej fshatrave me emërimet e tyre të rrugëve. Është e vërtetë që nganjëherë ka mundësi me u bërë gabim, sikurse rasti në Leshan shembull. Ka mundësi ndoshta me u bërë gabim sepse ska impiantë në fshatin Shirokë. Mirëpo në disa raste kur ka problem pronësore juridike, kryesia e fshatit e bën një kërkesë menaxherit të projektit, aprovohet dhe hynë në ditar. Mund ta kërkonte dosjen komplet të rrugëve ku janë shtru dhe si janë shtru. Sa i përket kanalizimeve, duhet ta kuptojmë që aty ku ka ujë çdo kush prej nesh paguan një taksë në fund të muajit për mirëmbajtjen e kanalizimeve. Ai që merr taksën, ai duhet të kujdeset për kanalizime. Te lagjja e Zekollëve unë e di që kemi interveni verës mirëpo sipas gjasave ajo trasë duhet të largohet afërsisht 400m, të fillon ndërtimi i ri. Është mirë me interveni por momentalisht nuk kemi kontratë sepse deri tash ska pas buxhetit. Tash fillojmë me procedura dhe në moment që kryhen procedurat atëherë do ta dërgojmë një kompani, me dalë në vendngjarje dhe me shiku si mund të rregullohet. Nuk është vetëm Bllaca por kanë problem edhe tjera fshatra.

Urim Suka - unë e di pjesën e propozimeve që vijnë nga kryesia e fshatrave por propozimet që vijnë nga ata nuk do të thotë që krejt me i marrë pa i kqyr në teren. Unë nuk du ta besoj që kryesia e fshatit Shirokë ta ka shtru aty: ndërtimi i impiantit të ujërave në Dubravë. Unë ju thashë këtu dhe ju prap e votuat dhe nuk deshët me ndryshu. Problemi te lagjja Zekolli me kanalizime është urgjente, mere si shenim sepse është urgjente. Ata ujë nuk kanë dhe nuk mundet me interveni Hidro Regjioni. Asnjë fjalë nuk e the për kontratën për rrugët në Reshtan.

Kryetari - kërkoje zyrtarisht me shkrim, të japim përgjigje.

Urim Suka - kjo a nuk është zyrtarisht që po e kërkoj tash.

Kryetari - i kemi 42 fshatra dhe nuk ka mundësi një Kryetar me i ditë përmendësh se ku janë bërë rrugët.

Urim Suka - për shkak të kësaj që unë sapo e ngrita dhe për shkak të këtyre problemeve që janë të mëdhaja, një numër të madh të zyrtarëve sot e ke të suspenduar dhe i ke nën aktakuzë. Tu kisha lut si përfaqësues i qytetarëve ta ndërroni këtë logjikë sepse kjo logjikë është duke i dëmtu edhe njerëzit edhe zyrtarët që po punojnë aty dhe kjo arrogancë dhe ky buxhet që u mirau tash ka me i rreziku edhe të tjerët për implementimin e vitit të ardhshëm.

Kryetari - kjo tregon mandati i tretë.

Sanie Kuçi Rexhepaj - po ndërlidhem me kushtet e punës të anëtarëve të kuvendit në këtë sallë ku jemi momentalisht. Sot e filluam mbledhjen me vonesë për shkak të mungesës së mundësive alternative të energjisë elektrike. Përveq asaj në votimin e buxhetit u desht edhe një herë me i numëru në mënyrë manuale votat, që kanë ndodh edhe në mandatin e kaluar, që ke thirr edhe seancë të jashtëzakonshme për shkak të gabimeve në numërimin manual. Salla është e re mirëpo po mungon sistemi elektronik i votimit dhe i numërimit të votave. Ne që jemi asambleist nga mandati i kaluar edhe tash, i kemi llaptopat që na ka siguru kuvendi mirëpo anëtarëve të ri kërkoj që sa ma parë ti sigurohet llaptopi e jo sikur neve që na u siguru 1 vit pa e krye mandatin. Përpos asaj ne llaptopat i kemi por skemi priza ku me i hap llaptopat me energji elektrike. Ju lus me investu në kushtet e punës së anëtarëve të kuvendit komunal. Kryetar a ka përfunduar kontratën për ndërtimin e shtëpisë së kultures "Ukë Bytyçi"? A është bërë pranimi teknik i objektit si dhe a është dhënë certifikata e përdorimit? Për shkak se ne jemi duke e përdor momentalisht

këtë objekt. Përpos asaj ne vijmë në mbledhje por nuk kemi vend ku me parku kerrin për shkak se podrumi i cili është i planifikuar për vendparkingje është i mbyllur dhe nuk është hap asnjëherë.

Kryesuesi - do ta kem parasysh shqetësimin që e ngrite.

Visar Kuçi - pasi Sania përmendi shtëpinë e kulturës, po e marr fjalën pasi kam qenë në menaxhim të projektit. Nuk është certifikuar. Të gjitha procedurat kanë përfunduar. Inspektorët i kanë mbikqyrë punimet por për shkak se dy ashensorë kanë mungu dhe ka përfunduar para vitit të ri faza përfundimtare.

Sanie Kuçi Rexhepaj - kontrata a është përmbyll me operatorin ekonomikë apo jo?

Visar Kuçi - kontrata është përmbyll me operatorin ekonomikë. Me kërkesën tonë dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dy ashensor kanë mungu. Është bërë një fazë përfundimtare dhe janë montu ashensorët dhe tash pasi janë montu ashensorët bëhet certifikimi i objektit.

Sanie Kuçi Rexhepaj - Drejtoria e Kulturës në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës a e kanë dorëzuar në inspektoriat kërkesën për pranim teknik të objektit?

Visar Kuçi - besoj që e kanë dorëzuar ose janë duke e përgadit dosjen për certifikim. Sqarim te buxheti. Ishte një rast në Mushtisht.P.sh. në sistem të adresave kur janë emëruar rrugët, ka pas ankesa. Ju kanë aprovu me komision në Asamble ankesat por agjensioni në vitin 2017-2018 ka dalë i ka vendos tabelat e rrugëve me emra të vjetër dhe ato që janë aprovu nga komisioni. Vitin e kaluar kur është bërë vendosja e numrave nëpër hyrje është rregullu kjo punë dhe sa e di unë në Mushtisht duhet me qenë rruga “Rrëzë malit”.

Sanie Kuçi - d.m.th ne po e shfrytëzojmë këtë objekt e realisht nuk është pranuar teknikisht nga ana e inspektoriatit e as nuk është dhënë certifikata e përdorimit nga ana e Drejtorisë së Urbanizmit. Nuk mund të përgjigje rreth podrumit të këtij objekti. Duke e marrë shembull këtë sallë ku jemi momentalisht janë fankllerat që janë jashtë funksionit. I keni vendos dy klima për shkak që një vit e ca ne e shfrytëzojmë këtë sallë ku verës ka qenë shumë nxehtë e dimrit shumë ftohtë. Një vit e sa ne nuk i kemi pas as kushtet bazike për me shfrytëzuar këtë sallë.

Nexhat Ramadani - unë e kam një pyetje por një pjesë e mori Sania, pikërisht për objektin ku jemi ne, shtëpinë e Kulturës. Skam qenë në asamble mirëpo përmes facebook kam pas një reagim. Si ka mundur të ndodhë që këtë objekt i cili ka kushtuar rreth 5 milion euro vendosën karriget e vjetra (të përdorura), të cilat vetëm janë maskuar dhe këtu jam dëshmitar prej ditës së parë që keni hyrë, edhe ju i keni pa. Dëshmia kryesore është që në këtë pozicion është e paraparë tjera karrige me u vendos. Pse është ndërruar pozicioni në të cilën thuhet që karriget duhet me qenë metal dhe me plastikë dekorative dhe ndërkohë ne i kemi karriget e drurit? Secili që jeni ulë i keni pa shenjat që këto tregojnë që janë të përdorura dhe unë mbaj përgjegjësi për këtë.

Visar Kuçi - e di që ka reagu Nexhati mandatin e kaluar në facebook dhe operatori ekonomikë e ka sqaruar. Unë mbaj përgjegjësi publike që këto karrige nuk janë të përdorura, janë të standardit më të lartë. Bashkë me Ministrinë e Kulturës e kemi bërë përzgjedhjen dhe disa nga karriget i kanë disa dëmtime gjatë transportit por janë karrige me standardet që i plotësojnë kushtet. Kanë ardhë nga jashtë shtetit.

Nexhat Ramadani - nuk ka të bëjë vetëm me këto të sallës. Poshtë prej fillimit janë karriget e dëmtura. Ne kemi edhe inqizim. Nuk mundën të gjitha karriget me u dëmtu për shkak të transportit. Edhe nëse dëmtohen për shkak të transportit, një tolerohet por si tolerohen 880 karrige.

Astrit Salihu - kam një pyetje lidhur me një shqetësim të banorëve të fshatit tonë që është ndër vite dhe nuk po futet në buxhet. Është udhëkryqi i rrugës Mushtisht-Dubravë -Savrovë-Sallagrazhdë, ku aty shpesh ka aksidente. Kryetar a do të bëhet një investim i tillë? Sa i përket ndërlidhjes së Visarit në rrugën Hazir Behlulit me Rrëzë malit, kjo nuk qëndron fare.

Kryetari - kemi bërë kërkesë para tre-katër viteve por ajo është pjesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe për atë rrethrotullim ata duhet me dhanë leje, ata duhet me punu.

Astrit Salihu - nëse ajo është pjesë e ministrisë së paku ne diçka duhet me ndërmarrë. Së paku një policë të shtrirë ose ndonjë shenjë nga ana e Sallagrazhdës dhe e Savrovës.

Kryetari - shenjat janë në dy anët. Kemi bërë kërkesë edhe te rruga Doberdelan-Samadraxhë-Rahovec ku ka pas nevojë për një rrethrotullim por janë pjesë e ministrisë.